



AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/317
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I12-2 Prot.
Nr. Dok.202500170/2

Tiranë _30_/07/2025

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë nr. 5
Kamëz, Tiranë.

Drejtuar: Z. Ilir PRODA
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Z. Elton ALUSHI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

TIRANË

Z. Besmir QIBINI
Shef i Komisariatit të Policisë nr. 5 Kamëz

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaratin e Policisë nr. 5 në Kamëz, Tiranë nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë nr. 5 në Kamëz, Tiranë në datën 13.02.2025, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe znj. Lindita Dedëgjoni me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të shoqëruarve/ndaluarve/arrestuarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit", aktet nënligjore, si dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria. Inspektimi ishte paparalajmëruar.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, si dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, në mugesë të Shefit të Komisarariatit, grupi inspektues u takua me zv. Shefin e Komisarariatit nr. 5 Kamëz, Tiranë, z. Sokol Llanaj, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Llanaj informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit, referuar inspektimit të mëparshëm lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit së këtij komisarati, sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm, i shoqëruar nga zv. Shefi i Komisarariatit, inspektoi në vend gjendjen e dhomave të shoqërimit, kushtet infrastrukturore dhe materiale të tyre, si dhe u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar, si dhe vizitoi zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, në lidhje me praninë e sendeve që ekspozojnë dhunë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit ishte thuajse e njëjtë si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, brenda këtyre ambienteve.

Drejtuesit e Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, si dhe punonjësit e policisë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë, gjatë inspektimit në ambientet e këtij institucioni.

Nga verifikimi i masave për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹, rezultoi se:

1. ***Ishte zbatuar rekomandimi***, për plotësimin me korrektësi të rubrikës “*Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmeve*” në “Regjistrin e personave të shoqëruar” dhe

¹ Shkresë nr. K4/I13-2 prot., datë 13.05.2024 “*Rekomandim për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë*”.

evidentimi i tyre në këtë regjistër sipas kërkesave të parashikuara në procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 dhe sigurimin e monitorimit të vazhdueshëm të tyre, si dhe nisjen e procedurave për evidentimin e përgjegjësve në lidhje me këtë çështje.

2. ***Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi***, për pajisjen e dhomave të shoqërimit me karrige, por jo me tavolina për qëndrimin e personave të shoqëruar në konflikt me ligjin.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi***, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për fillimin e punimeve sa më parë në zbatim të VKM-së nr. 505, datë 27.07.2022, e cila parashikon lëvrimin e fondeve në shumën 128.852.691 lekë “*Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë*”, sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “*Për Policinë e Shtetit*”, dhe aktit të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke siguruar ndërtimin e dhomave të shoqërimit në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore në fuqi, të ndara më vete për meshkuj madhorë, gra dhe të mitur, si dhe mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrimin e personave të shoqëruar dhe të monitoruara me kamera.
2. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi***, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisarariatit².
3. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi***, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
4. ***Nuk ishte zbatuar rekomandimi***, për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës së përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluari/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatët kryesisht.

Në përfundim të inspektimit, grupi inspektues vëren se megjithëse në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me krijimin e dhomave të shoqërimit dhe të drejtat ligjore të personave të shoqëruar, nisur nga kushtet aktuale, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:

² Kreu VI, pika 4/i1, procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Komisariati i Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, ishte i ndërtuar pjesërisht sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022³.

Nga inspektimi rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së komisarariatit. Në institucion kishte tre (3) dhoma shoqërimi, të cilat ndaheshin në një (1) dhomë shoqërimi për meshkuj madhorë, një (1) dhomë shoqërimi për gra dhe një (1) dhomë shoqërimi për të mitur, me dimensione 5x4m². Dhomat ishin me hapësirë të bollshme dhe me dritare, të cilat siguronin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, por kishte ndriçim edhe nga rrjeti elektrik. Gjithashtu, kishte gjenerator funksional për furnizimin me energji në rast defektesh. Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me orënditë e nevojshme, si karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, por mungonin tavolinat në këto ambiente. Secila dhomë kishte kapacitet deri në 4 persona të shoqëruar në konflikt me ligjin. Dera ishte prej druri, me mundësi për t’u mbyllur nga jashtë.

Dhomat ishin të lyera dhe me kushte të mira higjienike, të pajisura secila me tualet brenda, me sipërfaqe të mjaftueshme dhe të kompletuara me lavaman e rubinet për ujin, si dhe me pajisjet e nevojshme hidrosanitare. Ambientet e brendshme furnizohen me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje nga rrjeti i UK Tiranë. Ndërkohë, një problematikë e konstatuar është mungesa e një sistemi ngrohjeje/ftohjeje.

Në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë gjatë periudhës **01.01.2025** deri më **13.02.2025** ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **127** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ku saktësisht ishin të shoqëruar **112** shtetas madhorë, **8** gra dhe **7** shtetas të mitur. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, grupi i inspektimit u vu në dijeni se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë, ndonëse nuk ka dokumentim të këtij fakti. Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave të të shoqëruarve që në momentin e hyrjes në komisarariat, për të garantuar njohuritë e nevojshme për të drejtat e tyre.

Gjatë inspektimit u evidentua se në korridorin e ambientit të shoqërimit apo brenda dhomave të shoqërimit nuk ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, me qëllim që të jenë të aksesueshme nga personat e shoqëruar për t’u njohur me këto të drejta. Gjithashtu, afishimi i të drejtave duhet të bëhet dhe në vende

³ Kreu VII, pika 4/d, e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

të tjera të aksesueshme nga personat që ndodhen në mjediset e policisë, me qëllim për të dhënë mundësinë e leximit dhe kuptimit të këtyre të drejtave nga ana e tyre.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me *“Kartën e të drejtave”* në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisarariat policie. Nëpërmjet *“Kartës së të drejtave”* qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

“Karta e të Drejtave” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të *“Kartës së të Drejtave”* është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Gjithashtu edhe Komiteti për Parandalimin e Torturës në vijim (CPT)-ja, përshëndeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimit të sigurohen që të shoqëruarit që shkruajnë e lexojnë, e kuptojnë përmbajtjen e kartës së të drejtave.

Grupi i inspektimit u informua nga zv. Shefi i Komisarariatit, se në vitin 2022 ka ardhur një grup pune nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për të bërë matjet për projektin e rikonstruksionit të këtij institucioni në zbatim të VKM-së nr. 505, datë 27.07.2022 *“Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë dhe caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si njësi zbatuese”*⁴, ku është miratuar fondi në shumën 128.852.691 lekë.

Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë në zbatim të VKM-së nr. 505, datë 27.07.2022, *“Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë”*, ende nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është në procese të përzgjedhjes së firmës për ndërtimin/rikonstruksionin e komisarariatit⁵, sikurse përcaktohet në procedurën standarde dhe në zbatim të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit. Për rrjedhojë procesi vijon të jetë në fazën e vlerësimit dhe zgjidhjes së problematikave të konstatuara në projektin për rikonstruksionin e godinës nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson vendimin e Këshillit të Ministrave për rikonstruksionin e objektit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe aktit të procedurave standarde *“Rregullat*

⁴Në pikën 2 të këtij vendimi thuhet se: *“Në buxhetin e miratuar për vitin 2022 për Ministrinë e Brendshme në programin buxhetor “Policia e Shtetit”, 03440, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” shtohet fondi prej 25.770.538 lekë pa TVSH për: “Financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, që do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë”.*

⁵ Shkresa me nr.833/3 prot, datë 12.07.2025 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Shërbimet Mbështetëse drejtuar Shoqërisë “Arena MK” ShPK *“Për vlerësim dhe zgjidhje problematikave të konstatuara në projektin: “Rikonstruksion i godinës së Komisarariatit të Policisë Nr.5 Kamëz, Tiranë”.*

për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke ndërtuar dhomat e shoqërimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi të ndara më vete për rritur, femra dhe të mitur, dhe me mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera.

Ndërkohë, Institucioni i Avokatit të Popullit i konsideron të papërshtatshme vonesat në projektimin dhe zbatimin e këtij projekti dhe i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e plotë të këtij institucioni në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 27.07.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë”, që ka të bëjë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e komisarariatit, si dhe detyrimeve ligjore që kanë punonjësit e policisë për respektimin e garantimin e të drejtave që ju njih ligji këtyre personave.

Në ambientin e shoqërimit ishin të instaluar 5 kamera sigurie nga të cilat 2 kamera në korridorin e dhomave të shoqërimit dhe 3 kamera brenda dhomave të shoqërimit, të cilat shërbejnë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit, si dhe monitorojnë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimit në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre. Administrimi i kamerave kryhej nga specialistët e IT-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 30 ditë. Ky afat është në kundërshtim me “Rregulloren për vendosjen dhe përdorimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjediset e brendshme dhe të jashtme, të objekteve ku ushtrojnë aktivitetin strukturat e Policisë së Shtetit”⁶, në të cilën është e përcaktuar qartë se: *“Regjistrimet e kamerave të sigurisë do të ruhen për një periudhë deri në 60 ditë dhe më pas do të fshihen automatikisht”.*

Në Komisariatin e Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë, në fund të korridorit të katit të dytë të institucionit ishte një dhomë e mbajtjes së provave materiale dhe sipas informacionit të drejtuesve të komisarariatit, provat materiale futen në një qese të etiketuar në këtë ambient ose në rast të ekzaminimit dërgohen në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë “Blloku i Sigurisë”, ambiente të cilat janë ndërtuar sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurat standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin nr. 1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

⁶ Miratuar me Urdhrin Nr.1301, datë 03.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme **nga 1 orë deri në 5 orë** në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit⁷ dhe ishte i sekretuar.

Në këtë komisarlat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, por gjatë vitit 2025 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga ana e këtyre personave.

Gjithashtu, në këtë institucion administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë muajit janar të vitit 2025 kishte vetëm 7 të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin, sipas procedurës standarde (Lidhja model 5).

"Formulari i Raportit të Shoqërimit" plotësohej gjithashtu nga punonjësi i policisë që kishte kryer shoqërimin e personit për në komisarlat, sikurse përcaktohet në procedurën standarde.

Gjithashtu, "Procesverbalin me veprimet e kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar", në përfundim të veprimeve, kur shtetasi lihej i lirë, punonjësi i policisë e plotësonte atë në dy kopje, ku një kopje i jepej personit të shoqëruar, ndërsa kopja tjetër e procesverbalit, pasi administrohej nga punonjësi i informacionit, mbahej në dosje të veçantë dhe pas një jave dorëzohej në sekretari/arshivën e institucionit.

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohej nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

⁷ Kreu VII, e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Avokati i Popullit e konsideron krijimin e dhomave për marrjen në pyetje dhe procesin e intervistimit të personit, në ambientet e shoqërimit, të cilat duhet të jenë të monitoruara me sistemin e kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit, ashtu dhe ndaj personave të shoqëruar⁸.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar.

Ndërsa për të miturit në konflikt me ligjin ishte ambienti i veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin, i krijuar nga investimi i realizuar me fondet e World Vision, në partneritet me organizatën “Nisma për Ndryshim Shoqëror-Arsis”, në vitin 2019.

MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët, realizohen në një ambient të përshtatshëm, i cili është i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave më të miturit, pasi nga intervistimi i tyre në kushte dinjitoze shmanget dhe parandalohet traumatizimi i tyre.

Në strukturën organike të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë janë 12 specialistë policie, që kryejnë funksionin e OPGJ-së për rastet e hetimit të veprave të rënda penale dhe njëkohësisht ata kryejnë veprimet procedurale të marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar. Në këtë institucion kishte 6 zyra pune të OPGJ-ve dhe nga inspektimi i këtyre zyrave, nuk u gjendën sende apo mjete që ekspozojnë dhunë te personat e shoqëruar gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje të tyre.

Gjithashtu, në katin e dytë të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, ndodhej një zyrë e cila shërbente si zyrë pune për Specialistët e Policisë së Zonës (SPZ). Ky ambient ishte i pajisur me tavolinë, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orëditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, por nuk kishte të instaluar kamerat e monitorimit⁹.

Sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 për procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, në Kreun VI, pika 4/f parashikohet se: *“Dhoma për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar duhet të ketë të instaluar tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisjen elektrike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ, si dhe të instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin*

⁸ Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm të standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu kjo kërkon një regjistër të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje elektrike (audio dhe video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë e bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste. CPT raports; Armenia: visit 2010 [par.18]

⁹ Kreu VI, Pika 4/g, procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

elektrik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e Policisë Gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë”.

Gjithashtu në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit¹⁰ ku citohet se: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtme fizike apo presione psikologjike.*

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.

CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon që plani i rikonstruksionit të objektit në Komisarariat të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë të bëhet sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe aktit të procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ndër të tjera duke ndërtuar dhomat për marrjen në pyetje dhe procesin e intervistimit të personit të shoqëruar në konflikt me ligjin, të cilat duhet të jenë të monitoruara me sistemin e kamerave të sigurisë.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në këtë komisarariat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi, se për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”. Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet një kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Në dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale në nenet 34/a, gërma “c” dhe 34/b gërma “a”, si dhe në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, në pikën 4 të nenit 19, përcaktohet se: *“Çdo shtetas në momentin e privimit të lirisë në mjediset e Policisë së Shtetit, ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin mbrojtës”.*

¹⁰ Electronic recording of police interviews (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

Në mjediset e privimit të lirisë në Komisaratin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, mungonte lista e avokatëve të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, personave të arrestuar/ndaluar iu respektohej e drejta për avokat mbrojtës kryesisht dhe në rastin kur nuk kanë mundësi financiare, kontaktohet salla operative e policisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për të siguruar avokatët nga lista e avokatëve të miratuar nga organi i prokurorisë sikurse parashikohet në Kodin e Procedurës Penale.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 1 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të shoqëruarve me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

CPT gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri të zhvilluar në periudhën 4-15 Maj 2023 në institucionet policore, në raportin dërguar autoriteteve të Qeverisë së Shqipërisë, përsa i përket masave mbrojtëse themelore kundër keqtrajtimit të personit (përkatësisht, e drejta e njoftimit për ndalimin dhe e drejta për avokat dhe mjek), ka konstatuar se: *“Delegacioni dëgjoi disa pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e tyre për avokat kryesisht vetëm **pas një vonese të konsiderueshme**, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati. Gjithashtu janë marrë ankesa se **avokatët kryesisht nuk kanë ofruar ndonjë ndihmë kuptimplotë**. Për më shumë, informacioni i mbledhur gjatë vizitës sugjeronte se ekzaminimi fillestar mjekësor i personave të ndaluar në përgjithësi ishte ende i kufizuar tek pyetjet për gjendjen e tyre shëndetësore, pa kryer një ekzaminim fizik”*.

Përsa më sipër, CPT ka rekomanduar që: *“Autoritetet shqiptare duhet t’u kujtojnë të gjithë oficerëve të policisë **detyrimin ligjor për t’i dhënë akses ndaj një avokati që nga fillimi i heqjes së lirisë së një personi**. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa në konsultim me Dhomën e Avokatëve për t’u siguruar që avokatëve kryesisht t’u kujtohet **roli i tyre kyç në parandalimin e keqtrajtimit duke qenë të pranishëm në komisaratin e policisë dhe duke ndërhyrë që në fillim të privimit të lirisë, duke përfaqësuar sa më mirë të munden interesat e personave që janë të mandatuar të ndihmojnë dhe, më konkretisht, duke ndërmarrë veprimet e duhura sa herë që ka tregues se persona të tillë janë keqtrajtuar (ose mund të jenë) keqtrajtuar nga policia**. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa për të promovuar, në kuadrin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të avokatëve, një kulturë ku **mosndjekja e akuzave për keqtrajtim policor të konsiderohet si joetike dhe joprofesionale**”¹¹.*

Ndërkohë nga inspektimi, u evidentua gjithashtu një praktikë e mirë në Komisaratin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, që në rastet e shoqërimit apo arrestimit të personit të mitur në konflikt me ligjin, psikologu sigurohej tashmë nga lista e miratuar nga Urdhri i Psikologut. Kjo praktikë, ishte aplikuar që prej fillimit të muajit janar të vitit 2024, ku pasi njoftohej salla operative e Policisë së Shtetit psikologu sigurohej menjëherë sipas listës së miratuar nga institucioni përgjegjës. Gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët e policisë, personit të mitur në mjediset e policisë i ofrohej ndihmë ligjore dhe psikologjike sipas legjislacionit përkatës, në prani të avokatit mbrojtës, përfaqësuesit

¹¹ efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b

ligjor dhe psikologut. Nga informacioni rezultoi se, psikologu paraqitej në ambientet e komisariatit brenda një afati kohor jo më shumë se 1 orë nga ora e njoftimit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqisnin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë i shoqëronin në Qendrën Shëndetësore Kamëz, për të marrë ndihmën mjekësore.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për fillimin e punimeve sa më parë në zbatim të VKM-së nr. 505, datë 27.07.2022, e cila parashikon lëvrimin e fondeve në shumën 128.852.691 lekë *“Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë”*, sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe aktit të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke siguruar ndërtimin e dhomave të shoqërimit në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore në fuqi, të ndara më vete për meshkuj madhorë, gra dhe të mitur, si dhe mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin e personave të shoqëruar dhe të monitoruara me kamera.
2. Deri në zbatimin e projektit të ri, marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluari/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatët kryesisht.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

6. Marrjen e masave të nevojshme, për të afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në ambientet e dhomave të shoqërimit në vende të aksesueshme me qëllim që ata të njihen me të drejtat e tyre ligjore.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e dhomave të shoqërimit me orenditë e nevojshme, si tavolinë për qëndrimin e personave të shoqëruar në konflikt me ligjin.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

d.v